**VENDIM**
**Nr. 1127, datë 30.12.2020**

**PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2020, MIRATUAR PËR FONDIN SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT, NGA FONDI REZERVË I BUXHETIT TË SHTETIT PËR VITIN 2020**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, "Për buxhetin e vitit 2020", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në buxhetin e tij të miratuar për vitin 2020, në programin "Projekte zhvillimi", i shtohet fondi prej 170 000 000 (njëqind e shtatëdhjetë milionë) lekësh, që i transferohet Ndërmarrjes Industriale nr. 1 Tiranë, për kryerjen e pagesës pjesore të këstit të dytë të shitblerjes së godinës me numër pasurie nr. 1/645/ND, zona kadastrale 8210, Tiranë, sipas parashikimeve të nenit 2, të kontratës së shitjes nr. 180 rep., nr. 75 kol.

2. Efekti financiar, në masën 170 000 000 (njëqind e shtatëdhjetë milionë) lekë, përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, i miratuar për vitin 2020.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Ndërmarrja Industriale nr. 1 Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**